

# T'I JEPET FUND DHUNËS NË FAMILJE NË SHQIPËRI HAPAT E MËTEJSHËM

MJAFT DHUNES  
KUNDER FEMRAVE

**AMNESTY**  
INTERNATIONAL



## Kishte më se tre vjet që Lulin e rrihte i shoqi: *“Dëgjova për ligjin e ri – pushë diçka në televizor për një ligj që mbron gratë dhe e kuptova që duhet të shkoja në polici.”*

Në nëntor të vitit 2009, një nënë dyzetepesë vjeçare e katër fëmijëve nga fshati Goc afër Korçës, u rrah nga i shoqi me një shufër hekuri. Fqinjët e dëgjuan kur bërtiste dhe ngritën alarmin; më vonë gruan e çuan në spital me lëndime të rënda. Një dhunë e tillë kundër grave nuk është gjë e pazakonshe në Shqipëri: rreth një në tre gra shqiptare është viktime e dhunës në familje.

Tre vjet pas miratimit të Ligjit për Masat Kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare (Ligji për Dhunën në Familje), ky raport vlerëson përparimin e bërë nga autoritetet shqiptare në trajtimin e kësaj shkeljeje të përhapur të të drejtave të njeriut. Ai përfshin rekomandime për qeverinë shqiptare se si të bëjë përmirësime në zbatimin e ligjit, të sigurojë mbrojtjen e të gjitha grave që pësojnë dhunë në familje, dhe ta bëjë dhunën në familje një vepër penale më vete.

Ligji për Dhunën në Familje u miratua nga parlamenti shqiptar në dhjetor të vitit 2006 dhe hyri në fuqi më 1 qershor 2007. Ligji qe rezultat i një fushate të gjatë të zhvilluar nga një koalicion organizatash jo-qeveritare (OJQ), që çoi në hartimin e një peticioni për

parlamentin shqiptar, që u nënshkrua nga më se 10 000 persona. Ky ligj civil përfaqëson një përparim të rëndësishëm për parandalimin e dhunës në familje në Shqipëri, sidomos nëpërmjet futjes së urdhrit mbrojtës. Ky raport përqendrohet në ndikimin që ka ai mbi gratë që vuajnë nga dhuna në familje apo dhuna e ushtruar nga partnerët e tyre intimë. “Disa herë kisha vendosur të largohesha – i pyesja si familjen time ashtu edhe atë të burrit – dhe ata nuk mund të më ndihmonin, kështu që kthehesha përsëri tek ai, me shpresën se mund të ndryshonte. Ai më premtonte se do

të ndryshonte; por një javë më vonë kthehej përsëri njësoj si më parë.”

Loreta

Që nga miratimi i Ligjit për Dhunën në Familje ka pasur një rritje të ndjeshme në raportimin e rasteve të dhunës në familje. Në vitin 2007, pas hyrjes në fuqi të ligjit në qershor, në policinë shqiptare raportohet të jenë bërë 274 denoncime për dhunë në familje. Shifra të krahasueshme ekzistojnë edhe për nëntë muajt e parë të secilit prej viteve në vazhdim: nga janari në shtator 2008, policia regjistroi

### DETYRIMET E BRENDSHME TË SHQIPËRISË

Shqipëria është një nga shtetet nënshkruese e traktateve të të drejtave të njeriut, ndër të cilat edhe Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave e Kombeve të Bashkuara (KB), sipas së cilës autoritetet kanë detyrimin të parandalojnë dhe t'i mbrojnë gratë nga çdo formë dhune – përfshirë edhe atë nga bashkëshortët, partnerët, dhe anëtarë të tjerë të familjes. Masat për të luftuar dhunën kundër grave përcaktohen në ligjin për të drejtat e njeriut dhe standardet ndërkombëtare,

si për shembull, Deklarata e KB-së për Dhunën Kundër Grave dhe standardet rajonale të Këshillit të Evropës. Në këto masa përfshihen çrrënjësia e qëndrimeve që ushqejnë vazhdimin e dhunës kundër grave, duke siguruar dënimet e duhura penale, që autorët e këtyre krimeve të ndiqen penalisht dhe grave t'u ofrohen dëmshpërblime, si dhe tu afrohen shërbimet e duhura shëndetësore dhe shoqërore për t'i ndihmuar të rindërtojnë jetën e tyre – shërbime të cilat duhet tu jepen me respekt dhe dinjitet.





614 denoncime. Deri në shtator të vitit 2009, ishin bërë rreth 993 denoncime të rasteve të dhunës në familje. Si OJQ-të shqiptare ashtu edhe policia e interpretojnë këtë rritje si një gatishmëri dhe besim më të madh të grave të keqtrajtuara për të denoncuar dhunën në familje.

Denoncimet e bëra në polici përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të numrit të vërtetë të rasteve të dhunës në familje. Pjesa më e madhe e grave, sidomos në zonat rurale ku edhe të flasësh për dhunën në familje vazhdon të jetë një tabu e fortë, ende ngurrojnë ta denoncojnë dhunën në familje tek autoritetet.

## GRATË FLASIN HAPUR

*“Gjithmonë kam shpresuar se do të ndryshonte – deri sa erdhi aty ku nuk mbante më. Nuk mund të jetoja më ashtu. Isha tetë muaj shtatzënë, gati për të lindur, dhe ai më gjuajti me tavolinë. Pata aq frikë për foshnjën. Gratë duhet ta denoncojnë dhunën. Ato nuk duhet të jetojnë me të aq gjatë; ato nuk duhet t’ia lejojnë askujt t’i zhvlerësojë.”*

Luli, 26 vjeç, streha e Elbasanit

Sipas OJQ-së Qendra e Këshillimit për Gra e Vajza, sot ka më shumë gra që denoncojnë incidentet e dhunës në familje sepse e dinë, pjesërisht si rezultat i fushatave ndërgjegjësuese, se kanë të drejtën e mbrojtjes nga ligji. Shumica e këtyre denoncimeve bëhen nga gratë që jetojnë në Tiranë.

Deri në shtator 2008, për shembull, nga 993 denoncimet e bëra për dhunë në familje, 502 prej tyre u regjistruan në policinë e Tiranës. Megjithatë, edhe numri i denoncimeve nga gratë në qytete të tjera, si në Shkodër, Pogradec, Vlorë, dhe Tropojë, është gjithmonë në rritje. Pjesa më e madhe e ankesave bëhen nga gratë që i janë nënshtruar dhunës në familje për vite të tëra, por që vetëm tani kanë gjetur guximin dhe besimin për ta denoncuar atë, duke besuar se do të bëhet diçka për t’iu ardhur në ndihmë.

Ky besim i ri vjen pjesërisht nga veprimet e ndërmarra nga Policia e Shtetit, nën Ministrinë e Brendshme. Raportohet se në gusht të vitit 2007 Drejtori i Policisë së Shtetit u ka dhënë urdhër të gjithë oficerëve të policisë që të hetonin me kujdes çdo denoncim për dhunë në familje. Pak më vonë, në nëntor 2007, në

***lart: Një intervistë në lajmet televizive me një grua nga Goci, e shtruar në spital pasi u rrah nga i shoqi me një shufër hekuri, nëntor 2009.***

kuadrin e forcave policore të Tiranës u ngrit njësi e parë e specializuar që merret me dhunën në familje dhe mbrojtjen e fëmijëve. Po në Tiranë është nënshkruar edhe një Marrëveshje bashkëpunimi midis policisë dhe dy OJQ-ve: Qendra e Këshillimit për Gra e Vajza dhe Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL). Kjo siguron, ndër të tjera, që gratë të cilat bëjnë ankesë në polici, të referohen te QNL-ja për përfaqësim ligjor pa pagesë kur kërkojnë urdhra mbrojtjeje, dhe që të marrin këshillimin e duhur psikologjik dhe referimet e duhura nga Qendra e Këshillimit.

Në fund të vitit 2008, në qendra të mëdha urbane dhe rajone policie u krijuan njësi të specializuara policore për mbrojtjen e fëmijëve dhe dhunën në familje, por në zonat rurale zbatimi i ligjit dhe informimi për dispozitat e tij është ende sporadik.

Shifrat e kërkesave për ndihmë pranë OJQ-ve vazhdojnë të jenë më të larta se sa ankesat që



© Top-Channel TV, Albania



bëhen në polici. Në Shkodër, për shembull, në njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit 2008, u raportuan në polici 41 raste të dhunës kundër grave. Megjithatë, në vitin e mëparshëm, OJQ-ja "Gruaja tek Gruaja" në Shkodër kishte regjistruar 269 telefonata dhe u kishte ofruar këshillim psikologjik të drejtpërdrejtë 222 grave. Nga intervistat që ka bërë Amnesty International me gratë e keqtrajtuara dhe nga

raportet policore dhe ato të OJQ-ve, del se gratë që largohen nga dhuna ende parapëlqejnë më mirë të bëjnë shkurorëzim, se sa të bëjnë padi civile ose penale kundër bashkëshortëve të tyre.

## URDHRAT E MBROJTJES

*“Në dhjetor të vitit 2009 shkova në stacionin e policisë për herë të parë. Kisha një kushëri që punonte atje dhe ai më foli për urdhrat e mbrojtjes. Por në fillim, erdhi me mua në shtëpi një inspektor policie dhe foli me burrin, i cili i premtoi se nuk do të më prekte më. Por, sigurisht, ai vazhdoi të ishte i dhunshëm dhe, më 6 janar pasi më rrahu sepse nuk e gjeti darkën gati në tavolinë, vendosa të largohem. Shkova në polici dhe e denoncova, pastaj më vizitoi një mjek ligjor – i cili dëshmoi për lëndimet e mia në gjyq – dhe në orën 2 pasdite, më 7 janar, gjykata lëshoi një urdhër mbrojtjeje për mua dhe djalin.”*

Loreta, që tregonte se është rrahur nga burri gjatë gjithë periudhës dhjetëvjeçare të martesës së saj. Ajo vendosi të mos e ndiqte çështjen penalisht.

## LIGJI PËR DHUNËN NË FAMILJE

Ligji për dhunën në familje krijoi mekanizmin për t'u siguruar viktimave të dhunës në familje një urdhër mbrojtjeje, që mund të lëshohet nga një gjykatë civile me kërkesën e viktimës së kësaj dhune. Gjykata duhet ta shqyrtojë kërkesën brenda 15 ditësh. Ekziston gjithashtu edhe një dispozitë për urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes (në raste urgjente), që lëshohen nga gjykata brenda 48 orësh, në qoftë se abuzuesi përbën një "rrezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin, ose mirëqenien" e viktimës. Gjykata duhet të bëjë edhe një seancë tjetër gjyqësore brenda 20 ditësh për të vendosur nëse urdhri duhet zgatur më tej, apo duhet të ndërpritet.

A protection order may include, among other measures, the prohibition of contact with the victim, the prohibition of approaching the victim's home, workplace or other places frequented by the victim, and the prohibition of using force or violence against the victim. It may also include the prohibition of using or threatening to use firearms or other weapons, and the prohibition of contacting the victim's family members. The order may also include the prohibition of contacting the victim's employer, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's property. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's reputation, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's honor. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's dignity, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of movement. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of expression, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of religion. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of assembly, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of association. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of political participation, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of residence. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of occupation, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of education. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of marital status, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of parentage. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of citizenship, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of nationality. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of religion, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of language. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of culture, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of identity. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of appearance, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of name. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of gender, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of sexual orientation. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of sexual activity, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of sexual partners. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of sexual partners, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of sexual partners. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of sexual partners, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of sexual partners. The order may also include the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of sexual partners, and the prohibition of using or threatening to use force or violence against the victim's freedom of choice of sexual partners.

Futja e urdhrave të mbrojtjes është një hap i rëndësishëm drejt sigurimit të të drejtave të grave shqiptare për të jetuar pa dhunë. Në korrik 2007, Gjykata e Rrethit të Tiranës lëshoi urdhrin e parë të menjëhershëm për mbrojtje sipas ligjit të ri. Ky urdhër mbrojtjeje u lëshua për dy javë dhe i ndalonte një burri që të kërcëronte, sulmonte, apo komunikonte drejtpërsëdrejti me ish bashkëshorten dhe dy



fëmijët e tij. Në seancën tjetër, dy javë më vonë, gjykata e zgjati urdhrin e mbrojtjes edhe për tre muaj të tjerë.

Që nga ajo ditë, me qindra gra kanë bërë kërkesë për urdhëra mbrojtjeje nga bashkëshortët/partnerët e tyre (ose ish bashkëshortët/ish partnerët), pjesa më e madhe nga Tirana dhe qytete të tjera. Në tre muajt e parë të vitit 2008, 61 nga 74 kërkesa për urdhëra mbrojtjeje u bënë në Tiranë. Ngaqë nuk janë të ndara sipas personit ankues, statistikave vijuese përfshijnë, për shembull, edhe kërkesa të bëra nga gratë për t'u mbrojtur nga familja e burrit, ose baballarë dhe nëna që kërkojnë mbrojtje nga djem të dhunshëm. Sipas shifrave zyrtare të dhëna në njoftimet për shtyp, në nëntë muajt e parë të vitit u bënë 253 kërkesa, 168 në Tiranë dhe 71 në Durrës. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, pothuaj gjysma ishin për urdhëra të menjëhershëm mbrojtjeje. Në vitin 2009, policia inicioi 740 urdhëra mbrojtjeje (494 nga të cilët u regjistruan në Tiranë).

Sipas statistikave të Gjykatës së Rrethit të Tiranës për kërkesat për urdhëra mbrojtjeje që nga 1 janari 2009 deri në 31 dhjetor 2009, nga një numër i përgjithshëm prej 494

kërkesash, 127 (25 për qind) u miratuan; 310 u tërhoqën; 29 u refuzuan, dhe 28 procedime nuk u përfunduan.

Aktualisht, numri relativisht i lartë i urdhërave të mbrojtjes që shqyrtohen nga Gjykata e Rrethit të Tiranës nuk gjendet askund tjetër në Shqipëri. Në ekstremin tjetër, në qytetin e Beratit, urdhrat e parë të mbrojtjes u lëshuan për herë të parë vetëm në vitin 2008, pas trajnimit të profesionistëve përkatës nga Rrjeti Kundër Dhunës me Bazë Gjinore; edhe atëherë, në nëntë muajt e parë u bënë vetëm 3 kërkesa në gjykatë. OJQ-të e Elbasanit i thanë Amnesty International se gjykata e rrethit filloi të lëshonte urdhëra mbrojtjeje vetëm në vitin 2009, kur u dhanë 26 urdhëra të tillë.

Por, ndonëse ka një numër të madh grash që kanë bërë kërkesë në gjykatë për urdhëra të tillë, një pjesë e mirë më vonë i kanë tërhequr kërkesat e tyre. Duhet të merren masa për të siguruar që gratë, kur bëjnë këto kërkesa, të kenë mbështetje ligjore dhe çdo mbështetje tjetër për të cilën kanë nevojë dhe që urdhrat e mbrojtjes, kur lëshohen, të zbatohen.

**Lart dhe faqja 4: Tri gra tregojnë lëndimet e tyre gjatë intervistës për një dokumentar televiziv për dhunën në familje, 2009.**

## KËRKIMI I NJË URDHRI MBROJTJEJE

Në nëntor 2009 QNL botoi një analizë të 448 kërkesave të bëra për urdhër mbrojtjeje në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, nga 30 prill 2008 deri në 1 Qershor 2009. Rezultatet treguan se kërkuësja tipike ishte një grua e martuar e moshës nga 31 deri 40 vjeç, me dy fëmijë, me arsim të paktën deri në ciklin e mesëm, e punësuar dhe me origjinë qytetare. Pothuaj 10 për qind e kërkuësive ishin të divorcuara (por shpesh, kryesisht për shkak të mungesës së pavarësisë ekonomike, jetonin në të njëjtën adresë si edhe bashkëshorti i tyre). Kërkesa të tilla ndonjëherë përfshinin si kërkesën për mbrojtjen e gruas, ashtu edhe të fëmijëve të çiftit.

Sipas përfundimeve të nxjerra nga QNL-ja, në 80 për qind të 448 kërkesave nuk u dha urdhër mbrojtjeje. Megjithatë, kjo nuk ishte sepse gjykata i kishte refuzuar kërkesat



(kjo kishte ndodhur vetëm në pesë raste), por sepse gratë i kishin tërhequr kërkesat (në 27 për qind të rasteve), ose nuk ishin paraqitur në seancën gjyqësore (në më se 46 për qind të rasteve).

Në dokumentet gjyqësore nuk jepen arsyet e këtyre tërheqjeve, por Amnesty International dhe QNL mendojnë se disa gra mund të tërhiqen, ose të mos paraqiten në gjyq, si rezultat i presionit që ushtrohet mbi to nga abuzuesi ose familja e tyre. Të tjera tërhiqen për shkak të varësisë ekonomike nga abuzuesi, ose sepse nuk kanë besim tek aftësia e policisë për t'iu ofruar mbrojtje të mjaftueshme.

Disa gra i tërheqin ankesat e tyre pas seancës së parë gjyqësore, sepse abuzuesit tremben aq sa për të mos ushtruar më dhunë ose, të paktën, bëhen më pak të dhunshëm. Megjithatë, në disa raste të tilla, QNL pa se gratë që ishin tërhequr nga procedimi, më vonë, kur dhuna kishte filluar përsëri, kishin bërë një ankesë tjetër. OJQ-të tjera kanë vëzhguar se disa kërkesa të tilla janë braktisur pas përpjekjeve të gjykatës për të pajtuar çiftin, pavarësisht nga rekomandimet në "Librin e Trupit Gjyqësor" (në anglishte "Bench Book" - udhëzime për gjykatësit, botuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, OSBE), që përpjekje të tilla nuk janë të përshtatshme në këtë kontekst.

OJQ-të janë të shqetësuara se kur një viktimë denoncon dhunën në familje, policia ka tendencën që të fillojë menjëherë procedurën për kërkimin e një urdhri mbrojtjeje, ndonëse në disa raste mund të ketë mjete të tjera,

si ndjekja penale, që mund të jenë më të përshtatshme.

Sipas QNL-së, një numër i konsiderueshëm grash që kishin bërë kërkesë për urdhër mbrojtjeje, në seancën e parë të gjyqit nuk kishin përfaqësim ligjor, dhe as nuk ishin shoqëruar atje nga ndonjë punonjës social. Nga rastet e proceseve penale në vazhdim, vetëm një numër i vogël rastesh ishin iniciuar nga avokatë privatë, dhe asnjë nga prokuroria. QNL-ja sugjeron se mungesa e asistencës ligjore (ndihma ligjore pa pagesë ofrohet vetëm përmes disa OJQ-ve), mund të ndikojë në vendimet e disa grave për të bërë kërkesë ose jo (apo të bëjnë padi penale apo jo).

Studimi i QNL-së tregon se në mbi 58% nga 90 kërkesat e suksesshme në Gjykatën e Rrethit të Tiranës nga 20 prill 2008 deri në 1 qershor 2009, urdhrat mbrojtës ishin dhënë për një periudhë një vjeçare; disa urdhëra të tjerë mbrojtës ishin dhënë për periudha të shkurtra, 15 ditore, kurse disa të tjerë - ndonëse kjo nuk parashikohet në ligj - për një periudhë deri në dhënien e shkurorëzimit.

Megjithatë, në qoftë se nuk jepet urdhër mbrojtjeje i menjëhershëm, gratë vazhdojnë të jenë të rrezikuara deri në momentin që bëhet zbatimi i urdhrit të gjykatës. Procedurat gjyqësore shpesh zgjasin shumë. Sipas statistikave të Gjykatës së Rrethit të Tiranës për vitin 2009, 203 raste përfunduan brenda 2 muajve; 191 brenda dy deri në katër muajve; 72 për më shumë se gjashtë muaj; ndërsa 32 shkuan në apel.



## ZBATIMI I VENDIMIT PËR MBROJTJE

Në orët e para të mëngjesit të 14 gushtit 2009, Sotiraq Kurila u fut me dhunë në shtëpinë e familjes; kjo pas hyrjes në fuqi të urdhrit të mbrojtjes lëshuar në korrik nga Gjykata e Rrethit Durrës, që ia ndalonte të hynte në banesën familjare. Gruaja e tij, Aleksandra, kishte bërë kërkesë për urdhër mbrojtjeje pas incidenteve të përsëritura të dhunës në familje. Sotiraq Kurila akuzohet se tentoi ta vriste të shoqen me një thikë; duke lënduar rëndë edhe një nga vajzat e tij – që thuhet se u përpoq ta mbronte nënën duke e goditur të atin në kokë me një objekt të rëndë.

Ndaj Sotiraq Kurilës u ngrit padia për tentativë vrasjeje, keqtrajtim të një të miture, dhe shkelje të vendimit të gjykatës.



**majtas:** Gra nga Kashari, afër Tiranës, diskutojnë për dhunën në familje në një takim të organizuar nga Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara (UNICEF), 2004.

Sipas Arian Calaj nga OJQ-ja "Tjetër Vizion", "Fakti që viktimat duhet të jetojnë në të njëjtën çati me ushtruesin e dhunës nuk i jep asaj asnjë shans. Kjo ndodh sepse shteti nuk ka ngritur struktura për t'iu përgjigjur nevojave jo vetëm të viktimës, por edhe të anëtarëve të tjerë të familjes – streha, linja këshillore, programe rehabilitimi për viktimat, fëmijët e tyre, dhe dhunuesit."

Siç u shpreh për Amnesty International edhe Edlira Haxhiymeri nga Strehë e Tiranës, "Urdhri i mbrojtjes keqinterpretohet. Në shumë raste është gruaja ajo që duhet të largohet nga shtëpia, së bashku me fëmijët, dhe të kërkojë strehim emergjent, ndërsa dhunuesi vazhdon të jetojë si përpara, pa pasur asnjë pasojë."

Megjithatë, gratë që jetonin në këto streha i thanë Amnesty International se nuk donin të ktheheshin në banesën e familjes. Ato nuk kishin siguri dhe besim të mjaftueshëm tek autoritetet që të rrinin në shtëpitë e veta, dhe u ishte dhënë një urdhër mbrojtës ku parashikohej edhe qëndrimi i tyre në strehë.

Sipas Sevim Arbanës, nga OJQ-ja "Në Dobi të Gruas Shqiptare", "Organizata jonë, në parim, është kundër strehave, sepse duke u larguar nga shtëpitë e tyre, viktimat e dhunës në familje i krijojnë vetes një problem tjetër të madh: ato humbin shtëpinë, burri sjell aty një grua tjetër, ose mund ta shesë shtëpinë. Ne nuk e pranojmë që ato duhet të shkojnë në strehë, ligji thotë që dhunuesi duhet të largohet nga shtëpia, dhe jo viktimat."

Amnesty International gjithashtu shpreh shqetësim për problemet që lidhen me zbatimin e urdhrave të mbrojtjes. Në disa raste problemet janë procedurale: për shembull, gjykatat duhet t'u dërgojnë kopje të urdhrave të mbrojtjes, përfshirë edhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes - brenda 24 orësh nga lëshimi i tyre - viktimës, policisë dhe shërbimit social, dhe mosbërja e kësaj krijon vonesa në ekzekutimin e vendimeve të gjykatave.

Me gjithë ndihmën që u jepet grave për të bërë kërkesa për urdhra mbrojtjeje, policia nuk ka burime të mjaftueshme, dhe jo gjithmonë është e trajnuar për t'i ekzekutuar ata. Në shtator të vitit 2008, për shembull, pas rritjes së numrit të rasteve të denoncuar dhe urdhrave të mbrojtjes që vijuan si rezultat i tyre, policia e Durrësit u shpreh se kishte vështirësi në ofrimin e mbikëqyrjes dhe

mbrojtjes së nevojshme për viktimat. Për më tepër, policia zakonisht nuk hap procedime penale kundër dhunuesve që shkelin urdhrat e mbrojtjes, që, po qe se gjykata i shpall fajtorë, mund të dënohen me gjobë ose me burgim.

Megjithatë, problemi kryesor është dobësia e shumicës së urdhrave mbrojtës, që shkaktohet pjesërisht si rezultat i kombinimit të diskriminimit dhe pragmatizmit nga ana e organeve gjyqësore. Disa gjykatës hezitojnë të urdhërojnë dëbimin e partnerit dhunues nga shtëpia e familjes, ndonëse kjo është e parashikuar në ligj. Në raste të tjera, duke ditur që mungesat në strehim dhe të ardhurat e ulëta bëjnë që kushdo që largohet nga shtëpia shpesh mund të mbetet i pastrehë, gjykatësit shpesh japin urdhra që dhunuesi të jetojë në një pjesë të apartamentit (dhe viktimat në tjetrën).

## QEVERISJE E INTEGRUAR?

*“Shqipëria është një vend me ligje shumë të mira: e vetmja sfidë është zbatimi i ligjit. Ligji kundër dhunës në familje është një i tillë, por kërkon shumë përpjekje, informacion dhe pasion për t'u zbatuar. Ai hyri në fuqi në qershor 2007 dhe, që nga ajo kohë, kemi parë shumë pak angazhim nga qeveria, dhe me raste të rralla, si për shembull bashkitë e Vlorës, Shkodrës, Beratit dhe Rrëshenit, të cilat i kanë përkushtuar sasi të vogla parash kësaj çështjeje.”*  
Iris Luarasi, Qendra e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat

Ligji për Dhunën në Familje parashikon një rrjet autoritetesh – ku përfshihen edhe Ministrinë e Brendshme, të Shëndetësisë, të Drejtësisë dhe të Arsimit - “si përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen, përkrahjen, dhe rehabilitimin e viktimave.” Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSHB) luan rolin kryesor në çrënjosjen e dhunës në familje përmes zhvillimit dhe zbatimit të “Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje 2007-2010”. MPÇSSHBB është përgjegjëse për bashkërendimin e ndërhyrjeve nga departamentet përkatëse qeveritare, por ky bashkëpunim institucional ende nuk është vendosur plotësisht.

MPÇSHB është gjithashtu përgjegjëse për të siguruar trajnimin e profesionistëve përkatës, zakonisht nëpërmjet OJQ-ve, me financim nga donatorë ndërkombëtarë. QNL-ja, për shembull, u licencua nga MPÇSSHBB në nëntor të vitit 2007 për të organizuar dhe zhvilluar kurse trajnimi për profesionistët në sistemin e drejtësisë. Në vitin 2008 Programi për Zhvillim

i Kombeve të Bashkuara (PNUD) financoi trajnimin e 984 punonjësve përgjegjës për zbatimin e ligjit, ndër të cilët punonjës të shëndetësisë, policisë, gjykatës dhe prokurorë.

Në vitin 2008 MPÇSSHBB, në bashkëpunim me OSBE-në, filloi edhe një fushatë mbarëkombëtare për të promovuar njohjen me ligjet, ku përfshiheshin reklama televizive, tryeza të rrumbullakëta dhe shpërndarja e fletëpalosjeve për mbrojtje nga dhuna në familje. Megjithatë, MPÇSSHBB-ja nuk ka përmbyshur përgjegjësinë e vet për të financuar infrastrukturën mbështetëse të ligjit, përfshirë dhe ofrimin e shërbimeve.

*“Institucionet qeveritare nuk po përmbyshin detyrimet e tyre kur vjen puna për zbatimin e ligjit. Shumë prej zgjidhjeve praktike të përfshira në ligj ende nuk ofrohen. [Për shembull] ende nuk janë krijuar qendrat për rehabilitimin e burrave të dhunshëm, pas dhënies së urdhrit të mbrojtjes kundër tyre.”*  
Voksia, Qendra e Këshillimit Elbasan

Këtyre mendimeve u bëhet jehonë edhe në një raport të vitit 2009 të hartuar nga rreth 70 OJQ, të cilat mendojnë se ligji nuk po arrin rezultatet e duhura sepse autoritetet nuk kanë përmbyshur përgjegjësitë e tyre sipas Ligjit për Dhunën në Familje.

Për shembull, Ministria e Drejtësisë nuk ka siguruar avokatë të trajnuar për çështjet e dhunës në familje që të ofrojnë ndihmë ligjore pa pagesë; në vitin 2009 asnjë viktimë nuk u mbrojt në gjyq nga një avokat i caktuar prej gjykatës, kurse ligji i vitit 2008 për ndihmën ligjore ende nuk ka hyrë në fuqi.

Ministria e Arsimit ende nuk ka përmbyshur kërkesën ligjore për të hartuar programe dhe për të përgatitur materiale për shkollat e mesme dhe të larta për t'i edukuar nxënësit/studentët në lidhje me dhunën në familje.

Ministria e Shëndetësisë fillimisht premtoi në janar të vitit 2008 se do t'u jepte përparësi politikave që do t'u mundësonin punonjësve të shëndetësisë të identifikonin dhe regjistronin rastet e dhunës në familje, dhe t'u ofronin atyre

## ANËTARËSIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN

Në nëntor 2009 Këshilli Evropian ra dakord që Shqipëria të shqyrtohet për statusin e kandidatit për anëtar në Bashkimin Evropian (BE). Kjo i ngarkon përgjegjësi edhe më të mëdha autoriteteve shqiptare për të siguruar që legjislacioni dhe praktikat të jenë në përputhje me standardet evropiane. Më 26 nëntor 2009, Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë ku bën thirrje që të gjitha format e dhunës seksuale kundër grave, përfshirë edhe përdhunimin brenda martesës ose marrëdhënieve të tjera, dhe ato të kryera nga anëtarët meshkuj të familjes, të njihen si vepra penale në të gjitha shtetet anëtare. Rezoluta gjithashtu nxit ofrimin e ndihmës ligjore pa pagesë për të gjitha gratë që vuajnë nga këto lloje krimesh, në mënyrë që të sigurohet që një dhunë e tillë të ndiqet penalisht.

Shqipëria është gjithashtu anëtare e Këshillit të Evropës, i cili në vitin 2008 miratoi një rezolutë për krijimin e një konvente kuadër për të luftuar të gjitha format e dhunës kundër grave.





shërbime të specializuara. Megjithatë, si në vitin 2008 ashtu edhe në vitin 2009, klinikat shëndetësore në të gjithë vendin regjistruan vetëm rreth 100 raste. Sipas OJQ-ve vendore, pak qendra shëndetësore kishin kapacitetet e nevojshme për të ofruar ndihmën e duhur mjekësore; shumica prej tyre nuk kishin bërë referime të mëtejshme në shërbime të tjera të përkrahjes dhe as nuk kishin plotësuar dokumentacionin e kërkuar. Kjo do të thotë që grave nuk iu ishin dhënë vërtetimet e nevojshme mjekësore për t'i përdorur si prova në seancat gjyqësore në kërkim të urdhrave mbrojtës.

Po kështu, drejtoritë e mirëqenies sociale në organet e qeverisjes vendore në përgjithësi nuk i kanë krijuar ende strukturat e shërbimit të parashikuara në ligj. Këtu përfshihen edhe instalimi i linjave telefonike rajonale pa pagesë me shërbim 24-orësh (deri më sot kjo është

krijuar vetëm në Elbasan) të lidhura me policinë vendore, njësitë e shërbimit të urgjencës dhe OJQ-të; dhe krijimin e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe abuzuesit. Sipas një OJQ-je në Elbasan, *“Shërbimet sociale gjithmonë kthehen prapë tek ne, OJQ-të, dhe ne mbushim boshllëqet e tyre.”*

Ndërkohë, OJQ-të kanë marrë drejtimin për bashkërendimin e krijimit të shërbimeve në nivelin vendor. Rrjeti Kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe Trafikimit, i financuar nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Grave (UN Development Fund for Women), ka krijuar një sistem pilot referimi në Berat, Pogradec, Shkodër, Rrëshen dhe Vlorë. Këto “Këshilla Kundër Dhunës në Familje” përfshijnë përfaqësues qeveritarë, policinë, prokurorë të rrethit, punonjës të gjykatave, organizata të shëndetësisë dhe arsimit, zyra punësimi dhe OJQ, që ofrojnë edhe trajnim për profesionistët

**lart: Trajnim për shërbimet sociale shtetërore se si të njihet dhe trajtohet dhuna në familje, organizuar nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD), 2008.**

që merren me këto çështje. Nga shtatori 2008, deri në dhjetor 2009, në këto pesë zona janë referuar në organet përkatëse 204 raste (91 për qind gra dhe vajza). Projekti është shtrirë edhe tek gratë që më parë nuk kishte shumë të ngjarë të denonconin dhunën: rreth 76 për qind e referimeve ishin gra fshatare, ndërsa 50 për qind ishin të papuna.

Nja dy bashki i kanë dhënë OJQ-ve grante të vogla për t'i ndihmuar në punën e tyre me viktimat e dhunës në familje, por fonde të tilla janë të kufizuara dhe ekziston nevoja për ndihmë të mëtejshme, përfshirë edhe krijimin e strehave.



## GRATË KANË NEVOJË PËR STREHA

Në gusht të vitit 2009, Luli, një nënë njëzetegjashtëvjeçare me një foshnje të vogël, shkoi në stacionin e policisë për të kërkuar ndihmë dhe një urdhër mbrojtës, pasi i shoqi e kishte flakur jashtë shtëpisë së tyre në Durrës. Ajo i tha Amnesty International se i shoqi kishte qenë i dhunshëm me të që pas muajit të parë të martesës së tyre tre vjeçare. Ajo vendosi ta lerë, pas një incidenti kur ai ishte kthyer në shtëpi i dehur dhe e kishte rrahur me rrip kur ajo i jepte gji djalit. "Ishte hera e fundit që do ta lejoja një gjë të tillë." Nëna e saj nuk e pranoi përsëri në shtëpi, duke i thënë që duhet të rrinte me burrin. Duke mos pasur strehë në Durrës, Luli në fillim qëndroi për tri net në spital (ku policia i gjeti një shtrat, sepse djali i saj gjashtë muajsh ishte i sëmurë), dhe pastaj gjeti një vend në një strehë në Elbasan, rreth 70 km larg, ku e pranuan pas marrjes së urdhrat të mbrojtjes nga Gjykata e rrethit Durrës.

Në Shqipëri nevoja për streha është jashtëzakonisht e madhe. Shumë pak gra mund të presin mbështetje nga familjet e tyre, dhe, megjithëse OJQ-të u ofrojnë këshillim viktimave të dhunës në familje, gratë që i ikin dhunës shpesh nuk kanë se ku të shkojnë.

Në nëntor 2009 "Mirelës", nga Tirana, iu desh të kërkonte strehë tek Qendra e Këshillimit "Hapat e Lehtë" në Shkodër (rreth 100 km larg).

**Iart:** Fletëpalosje që Amnesty International dhe OJQ-të u kanë shpërndarë grave në Shqipëri.

I shoqi e rihte vazhdimisht dhe ishte përpjekur ta detyronte të bëhej prostitutë. Në fund të vitit 2009, streha e Elbasanit – e financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë – ishte e vetmja strehë që funksiononte në mënyrë të plotë posaçërisht për viktimat e dhunës në familje. Fondet e strehës së Tiranës, që drejtohet nga OJQ-të, u ndërpre në korrik të vitit 2009, dhe si rezultat kjo qendër ishte në gjendje të ofronte vetëm strehim të përkohshëm për një



Në tetor 2009, Lirie Neziri dhe katër fëmijët e saj kërkuan strehë për t'i shpëtuar të shoqit, që ishte vazhdimisht i dhunshëm, në një spital në Pukë, ku për një javë të tërë fjetën në dyshemenë e korridorit. Pas publikimit të rastit në media, policia e arrestoi burrin dhe ajo me fëmijët u strehuan përkohësisht në një qendër sociale në Shkodër.



numër shumë të vogël rastesh urgjente. Grave si Mirela iu desh të kërkonin strehë në qytete të tjera deri në janar 2010, kur streha e Tiranës u rihap, me fondet e një OJQ-je zvicerane.

Disa gra janë pranuar në streha që përkujdesen për gratë e trafikuar. Por në shumicën e qyteteve nuk ka struktura të tilla. OJQ-të e Durrësit kanë bërë thirrje që në qytetin e tyre të krijohet një strehë; për shkak

të mungesës së një strehe të tillë, në dhjetor të 2008-s, oficerë policie, juristë dhe punonjës të OJQ-ve, ndonjëherë i strehoni gratë përkohësisht në shtëpitë e tyre.

Në dhjetor 2009, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale shpalli planet për një Qendër Kombëtare për Rehabilitimin e Viktimave të Dhunës në Familje, që mendohet të strehojë deri në 50 gra, përfshirë edhe gra të trafikuar,

dhe që është planifikuar të hapet në qershor të vitit 2010. Disa OJQ kanë shprehur shqetësimet e tyre për këtë projekt, sepse parapëlqejnë krijimin e strehave më të vogla vendore. Gratë që i ikin dhunës në familje dhe gratë e trafikuar kanë nevojë shumë të ndryshme mbështetjeje dhe këshillimi. Këtyre nevojave duhet t'u jepet përgjigje ndarazi, mundësisht në streha të vogla vendore – edhe këto thuhet se janë premtuar nga MPÇSSHJ-ja në dhjetor të vitit 2009.





© Qendra e Këshillimit për Gra e Vajza në Tiranë

## GRATË KANË NEVOJË PËR PAVARËSI EKONOMIKE

*“Nuk e di se si do të jetë e ardhmja ime. Jam 50 vjeç dhe kam frikë se asnjë nuk do të më ndihmojë. Po bëj një kurs për kuzhinierë dhe po mësoj italisht. Kam shkuar tek shërbimi social për t'u regjistruar për punë dhe kam kërkuar asistencë [sepse vuaj nga reumatizma], por është shumë e vështirë të përmbushësh kushtet kur nuk nje njerëzit e duhur. Koha më e vështirë është kur largohesh nga streha – je krejt e vetme, pa mbështetje, pa shtëpi, pa punë, dhe është shumë e vështirë ta përbalosh jetën. Shumë gra përfundojnë përsëri në rrugë, atje ku ishin në fillim. Qeveria duhet t'i ndihmojë gratë, ndoshta me ndonjë lloj ndihme sociale, ose me strehim me qira të ulët.”*

Besa, që e la të shoqin pas 29 vitesh dhune

Dhuna në familje është një aspekt mjaft i përhapur i diskriminimit të grave në Shqipëri. Një diskriminim i tillë shpesh bën që gratë të mos e denoncojnë dhunën në familje në polici, të mos kërkojnë urdhra mbrojtjeje, të mos bëjnë padi penale, apo ta lënë abuzuesin. Por është mungesa e pavarësisë së tyre ekonomike – shpesh rezultat i diskriminimit në arsim dhe punësim – që ua bën edhe më

të vështirë grave të largohen nga mjediset e dhunës. Edhe ato që mund të largohen, përballen me vështirësi të mëdha për të gjetur banesë, punësim, dhe për të mbajtur kujdestarinë e fëmijëve.

*“Gratë që duan t'i shpëtojnë dhunës nuk mund ta përballojnë taksën që i paguhet gjykatës për të bërë shkurorëzimin. Ato madje duhet të paguajnë nga xhepi i vet edhe psikologun që i pyet fëmijët se me cilin prind duan të qëndrojnë; në pjesën më të madhe burrat nuk e paguajnë shumën për mbajtjen e fëmijëve që cakton gjykata.”*

Voksia, Qendra e Këshillimit Elbasan

Ndërkohë që Besa për gjashtë muaj pas largimit nga streha do të marrë asistencë për pagimin e qirasë së një apartamenti, gra të tjera nuk janë aq me fat. Gratë që i shpëtojnë dhunës nuk kanë përparësi për sa i përket strehimit shoqëror, e as nuk u jepet ndonjë ndihmë e specializuar apo ndihmë për shpenzimet shëndetësore. Ato nuk kanë marrë asistencë financiare apo të ndonjë lloji tjetër nga shteti (megjithëse në marsin e vitit 2001 u shpall që disa qindra gra do të merrnin një pagesë mujore prej 3000 lekësh (21Euro), në bazë të amendamenteve që iu bënë ligjit

**Iart: Qendra e Këshillimit për Gra e Vajza në Tiranë drejton takimin e një grupi pune të OJQ-ve që punojnë në fushën e dhunës në familje në Shqipëri, qershor 2009.**

për asistencë ekonomike). Në vend të kësaj, gratë gjejnë përkrahje tek OJQ-të e specializuara, si Refleksione dhe “Në Dobi të Gruas Shqiptare”, të cilat i ndihmojnë të kenë qasje në arsim, kurse kualifikimi dhe punësim.

*“Tani ndjehem shumë më e qetë, dhe do të rri në strehë deri sa të finalizohet shkurorëzimi. Nuk besoj se do të kthehem në Durrës, por kudo që të shkoj do ta kem të vështirë të gjej punë. Mendoj se ligji duhet të ofrojë më shumë mbrojtje, përparësi për shëndetin dhe punësimin. Vetëm urdhëri i mbrojtjes nuk mjafton.”*

Luli

Megjithatë, deri sa qeveria të trajtojë çështjen e diskriminimit sistematik institucional dhe social të grave, përfshirë fushat e mundësive për punësim, strehim dhe përkujdes shëndetësor, shumë gra dhe fëmijët e tyre nuk do të jenë gjendje të largohen dhe t'i shpëtojnë dhunës në familje.



Seancë individuale këshillimi në Qendrën e Këshillimit për Gra dhe Vajza në Tiranë, nëntor 2008.

## KRIMINALIZIMI I DHUNËS NË FAMILJE

*"Urdhrat e mbrojtjes shërbejnë për të pakësuar dhunën, por nuk e dënojnë atë. Ky është ende një problem shumë i madh. Kriminalizimi i dhunës në familje do të ndihmonte në pakësimin e dhunës në familje. Do të ishte një masë detyruese për të cilën ka shumë nevojë."*

Evis, Qendra e Këshillimit Elbasan

Amnesty International është e mendimit se, për t'u dhënë grave mbrojtje të mëtejshme, autoritetet shqiptare duhet të bëjnë amendamente ligjore që e bëjnë dhunën në familje një vepër penale sipas ligjit. Përveç kësaj, mungesa e një ligji të tillë bën që autoritetet shqiptare të mos e njohin përhapjen e plotë të dhunës kundër grave në familje.

Tre vjet pas miratimit të ligjit civil për Dhunën në Familje, është ende e pamundur të kuptohet nga të dhënat në dispozicion nëse ka pasur ndonjë rritje të numrit të ndjekjeve penale të dhunës në familje. Rastet e dhunës në familje tani ndiqen penalisht në bazë të dispozitave për shkeljet penale të Kodit Penal të Shqipërisë (për shembull, vrasje, kërcënim, rrahje); statistikave gjyqësore nuk tregojnë se sa prej këtyre ndjekjeve penale ose dënimeve lidhen me dhunën në familje. Amnesty International ka kërkuar informacion nga autoritetet në janar 2010 për këto ndjekje penale, por nuk ka marrë përgjigje deri në mars 2010.

Statistikat e deritanishme nuk tregojnë se sa procese penale janë filluar (pas ankimit në

## DHUNA QË ÇON NË VETËVRASJE

Ka pasur një rritje në numrin e ndjekjeve penale të burrave që i kanë shtyrë gratë e tyre të kryejnë vetëvrasje për shkak të dhunës së ushtruar prej tyre. Në dhjetor 2007, Tomorr Merja u dënua sepse e kishte shtyrë gruan e tij, Ornela Prifti, të kryente vetëvrasje për shkak të keqtrajtimit të përsëritur; ai u dënua me 20 muaj burg. Sipas një OJQ-je vendore, në janar 2008, vetëm në rrethin e Elbasanit pati 12 raste të regjistruara tentativash për vetëvrasje nga viktimat femra të dhunës në familje. Në nëntor të vitit 2009, Qendra e Këshillimit të Grave dhe Vajzave në Kukës raportoi pesë vetëvrasje dhe 13 tentativa vetëvrasjeje për shkak të dhunës në familje në atë rreth në dy vitet e fundit.

Në dhjetor 2009, Petrit Goga u ndoq penalisht sepse kishte shtyrë gruan e tij Mimoza të bënte

vetëvrasje, për shkak të keqtrajtimit të vazhdueshëm që pësonte prej tij. Sipas artikujve në gazetën e përditshme Metropol, kunata e tij, dëshmitare në gjyqin e zhvilluar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, i tha gjykatësit: *"E dini zotëri, se të gjitha gratë në vendin tonë rrihen nga burrat e tyre. Është normale. Burri vjen në shtëpi me nerva, ose i lodhur nga puna, dhe kur nuk është në qejf, të rreh. Këtë i bëri edhe Petriti të shoqes. E rrahu natën vonë. Ndonjëherë vinte nga puna i dehur. Shpërthente derën dhe rrihte gruan."* Ajo i tha gjykatësit se Mimoza ishte rrahur një natë përpara se shkoj të mbytej. Gjykatësi e pyeti nëse i shoqi e rrihte edhe atë *"Ju e dini përgjigjen. S'ka kuptim t'jua them dy herë. Edhe mua më rreh burri."*

polici), apo se çfarë rezultati kanë pasur ato. Sipas burimeve të policisë, për shembull, nga janari deri në maj 2008, në gjykatën e rrethit të Tiranës u filluan 51 procese penale që lidheshin me dhunën në familje, por nuk ka statistika për rezultatin e ndjekjes penale në këto raste.

Artikuj nga shtypi sugjerojnë se vetëm një numër relativisht i vogël shkon deri në ndjekje penale, përveç rasteve kur rezultojnë në vdekje, lëndime të rënda ose kërcënim për jetën, në raste të tilla është detyrë e prokurorit të fillojë ndjekjen penale. Në rastet kur lëndimi fizik i pësuar nga gruaja përkufizohet në ligjin shqiptar si "i lehtë" - që do të thotë se lëndimi

shkakton që viktimat të jetë e paaftë për punë për më pak se nëntë ditë - prokurori publik nuk është i detyruar të fillojë ndjekje penale; këtë duhet ta bëjë viktimat. Gratë shpesh hezitojnë ta bëjnë këtë nga frika e hakmarrjes ose presioneve të tjera familjare.

Në fakt, ligji i ri mund të ketë bërë që të ketë më pak gjasë për ndjekje penale. Sipas OSBE-së dhe OJQ-ve vendore, për shembull, disa policë dhe prokurorë kishin mendimin e gabuar se fillimi i procedurës civile për kërkimin e një urdhri mbrojtës përjashton mundësinë e hapjes së çështjes penale. Dhe në fakt, nga 228 kërkesa për urdhra



mbrojtjeje që u bënë pranë Gjykatës së Rrethit të Tiranës në vitin 2008, vetëm 32 prej tyre u shoqëruan me ndjekje penale.

Megjithatë, kjo mund të jetë edhe çka duan vetë gratë. Shumë prej tyre nuk duan të bëjnë padi penale kundër bashkëshortëve dhe parapëlqejnë më mirë të kërkojnë shkurorëzim: siç u shpreh Loreta për Amnesty International, *“Unë desha vetëm që ai të vazhdonte jetën e vet.”*

Sipas Edlira Haxhiymerit nga Streha e Tiranës, *“Kur gruaja shkon në polici dhe përfshihet edhe familja e saj, ajo kërkon vetëm urdhër mbrojtjeje dhe [familja] zakonisht kërkon që vetëm të mbyllet çështja me paqe dhe sa më shpejt. Kështu që më e shumta që ato kërkojnë është divorci; rrallë dëgjohet për ndjekje penale dhe urdhrat mbrojtjeje.”*

Kriminalizimi i dhunës në familje ende nuk ka një mbështetje të përgjithshme nga të gjithë zyrtarët qeveritarë apo OJQ-të, megjithatë, mbështetja në qeveri ekziston – përfshirë mbështetjen e Zëvendës Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta – për të amenduar Kodin Penal në mënyrë që dhuna në familje të njihet si vepër penale. Disa OJQ dhe juristë që punojnë me viktimat e dhunës në familje janë gjithashtu në favor të kriminalizimit të dhunës “së përsëritur” dhe sistematike në familje, përfshirë edhe dhunën psikologjike dhe ekonomike, që nën legjisllacionin aktual nuk mund të ndiqen penalisht.

Fakti që dhuna në familje nuk është njohur si një vepër penale më vete në Shqipëri

## QËNDRIMI I AMNESTY INTERNATIONAL

Amnesty International mirëpret nismat që synojnë çrrënjosjen/trajtimin e problemit të dhunës në familje.

Organizata nuk bën thirrje që të gjitha rastet dhe të gjitha rrethanat pa përjashtim të dhunës në familje të bëhen vepra penale. Përkundrazi, Amnesty International thekson se kodi penal ekzistues (që lidhet me vrasjet, rrahjet, etj.,) duhet të zbatohet në mënyrë konsistente edhe në rastet e dhunës kundër grave në sferën familjare dhe/ose nga partnerët ose anëtarët e familjes. Dhuna në familje nuk duhet të trajtohet në mënyrë as më të veçantë e as më të butë se sa format e tjera të dhunës, ose se sa dhuna kundër burrave.

Duke theksuar rëndësinë e zbatimit konsistent të kodit penal në rastet kur gratë janë viktimat, në disa vende Amnesty International mbështet edhe thirrjet për legjisllacion shtesë, enkas për dhunën në familje, duke e bërë atë vepër penale më vete,

ka pasoja serioze. Ajo çon në shkeljen në vazhdimësi të të drejtave të grave për integritet fizik e mendor dhe, në disa raste, shkelje të të drejtës së tyre për jetë. Njohja e dhunës në familje në Kodin Penal të Shqipërisë do të siguronte që kjo shkelje të trajtohej me po aq seriozitet si edhe sulmet e tjera të rënda.

Kriminalizimi do të bënte gjithashtu të mundur që autoritetet shqiptare të jenë më efektive në monitorimin, analizimin dhe çrrënjosjen e dhunës në familje, sepse rastet

duke pasur parasysh karakteristikat e saj specifike dhe përhapjen që ka.

Duke e bërë dhunën në familje një vepër penale më vete, shteti shqiptar do të theksonte dënimin që i bën shoqëria kësaj dukurie të përhapur dhe të papranueshme. Përveç kësaj, për ta trajtuar problemin e dhunës në familje në mënyrë efektive, kanë rëndësi të veçantë të dhënat e sakta për shpeshësinë e saj dhe për masat e marra për parandalimin dhe dënimin e saj. Dokumentet gjyqësore janë një burim i këtij informacioni dhe, duke e bërë dhunën në familje një vepër penale më vete, autoritetet do të lehtësonin mbledhjen e këtyre të dhënave.

Shteti duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'i mbrojtur gratë nga kanosjet dhe shtrëngimet për të tërhequr ankesat e tyre, por, nga ana tjetër, gratë nuk duhet të pengohen kur duan ta tërheqin ankesën me dëshirën e tyre.

e dhunës në familje do të tregoheshin në statistikat gjyqësore.

Kriminalizimi i hapur i dhunës në familje do të theksonte faktin që shoqëria e dënon këtë dhunim të përhapur dhe të papranueshëm të të drejtave të njeriut. Po kështu, ai – ashtu si edhe urdhrat mbrojtës – mund t'u japin grave besimin që të bëjnë padi penale, duke siguruar kështu që viktimat të kenë një qasje më efektive në drejtësi.

## PËRFUNDIM

Katër vjet pas raportit të Amnesty International *Shqipëria. Dhuna kundër grave në familje: "Nuk është turpi i saj"* (EUR 11/002/2006) dhe tre vjet pas miratimit të Ligjit për Dhunën në Familje, Amnesty International vëren se është bërë përparim në trajtimin e problemit të dhunës në familje. Sot janë më të shumta gratë që kanë besim ta denoncojnë dhunën në familje tek autoritetet. Megjithatë, pavarësisht nga numri në rritje i kërkesave për urdhër mbrojtjeje që janë bërë, qeveria shqiptare duhet të marrë masa të mëtejshme për zbatimin e ligjit dhe për të siguruar parandalimin e dhunës në familje, mbrojtjen prej saj, dhe ndjekjen penale.

**kapaku: Pamje e Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë, shkurt 2008. © Alfredo Caliz/Panos**

## REKOMANDIME:

### Amnesty International nxit autoritetet shqiptare që:

- të bëjnë amendamente në Kodin Penal për të kriminalizuar dhunën në familje, përfshirë edhe abuzimin sistematik psikologjik dhe ekonomik;
- të lirojnë viktimat e dhunës në familje nga përgjegjësia për të nisur procedim penal në rastet e "lëndimeve të lehta trupore";
- të forcojnë ligjin për shkeljet e urdhrave mbrojtës;
- të sigurojnë që Ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë të bashkëpunojnë për hartimin e statistikave, të ndara sipas gjinisë dhe etnicitetit, mbi denoncimet e rasteve të dhunës në familje dhe të veprimeve të mëtejshme që janë ndërmarrë, përfshirë ndjekjet penale dhe/ose kërkesat për urdhra mbrojtjeje;
- të përmirësojnë procedurat, shtojnë burimet dhe të vazhdojnë trajnimin e policëve, prokurorëve dhe punonjësve të gjykatave dhe gjykatësit, për të siguruar zbatimin efektiv të urdhrave mbrojtës;
- të garantojnë ndihmë ligjore falas për viktimat e dhunës në familje;
- të ndërmarrin studime për rastet e tërheqjes së padive penale dhe të kërkesave për urdhra mbrojtës.

### Amnesty International i bën thirrje MPÇSSHB, që në bashkëpunim me OJQ-të:

- të krijojë ose mbështesë strehat vendore për strehimin e viktimave të dhunës në familje, si dhe një linjë telefonike falas 24-orëshe;

- të ofrojë burime të mjaftueshme për programet që synojnë pavarësinë ekonomike të viktimave të dhunës në familje, përfshirë edhe mundësitë për trajnime dhe punësim, dhe të marrë masa që ato të përfshihen në programet e asistencës sociale dhe strehimit social;
- të krijojë një sistem të integruar ndër-ministerial për regjistrimin e rasteve të dhunës në familje dhe të marrë masa për botimin e rregullt të statistikave, si dhe të informojë politikantë qeveritare në luftën kundër dhunës në familje;
- të nxisë dhe mbështetë një ndërgjegjësim të mëtejshëm për dispozitat e ligjit për dhunën në familje dhe masat e mbrojtjes (përfshirë edhe urdhrat mbrojtës), sidomos në zonat fshatare.

### Amnesty International nxit Komisionin Evropian që:

- monitorojë masat e marra nga Shqipëria për të parandaluar dhunën në familje, për të mbrojtur gratë dhe për të ndjekur penalisht dhunën në familje;
- mbështesë financiarisht krijimin e strehave, si dhe të strehimit afatgjatë në vazhdimësi;
- ndihmojë në hartimin e programeve që sigurojnë pavarësinë ekonomike të të gjitha grave, përfshirë viktimat e dhunës në familje;
- ndihmojë autoritetet në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore dhe Eliminimin e Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje.

MJAFT DHUNES  
KUNDER FEMRAVE  
AMNESTY  
INTERNATIONAL



Amnesty International është një lëvizje globale me 2,8 milion përkrahës, anëtarë dhe aktivistë në më se 150 vende dhe territore, që bëjnë fushatë për t'i dhënë fund shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.

Vizioni ynë është që çdo person të gëzojë të gjitha të drejtat e mishëruara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në standardet e tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Ne jemi të pavarur nga çdo qeveri, ideologji politike, interes ekonomik ose besim fetar, dhe financohemi kryesisht nga anëtarët e organizatës dhe donacionet publike.

Mars 2010  
Indeks: EUR 11/001/2010

Amnesty International  
International Secretariat  
Peter Benenson House  
1 Easton Street  
London WC1X 0DW  
United Kingdom  
[www.amnesty.org](http://www.amnesty.org)